



SHKOLLË VERORE, FIRENCE - ITALI “HISTORI KRAHASUESE DHE TRANSNACIONALE”

Departamenti i Historisë dhe Civilizimit pranë “*European University Institute*” - Firenze, Itali, organizon shkollë verore për “*HISTORI KRAHASUESE DHE TRANS-NACIONALE*”.

Shkolla verore do të zhvillohet në gjuhën angleze, por edhe gjuhët tjera që fliten në kuadër të Bashkimit Evropian janë të pranueshme. Kjo shkollë do të mbahet nga data **13 - 17 Shtator 2010**, në njëren nga vilat më të bukura në botë, Villa Schifanoia, në qytetin Firenze të Italisë.

Kriteret e aplikimit:

- Kandidatët duhet të jenë studentë të historisë, shkencave sociale dhe fushave tjera të ngjashme
- Kandidatët duhet të jenë të diplomuar apo të jenë në vitin e fundit të studimeve

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi duhet të bëhet në formë elektronike. Formularin e aplikimit e gjeni në ueb-adresën:

- <http://www.eui.eu/Documents/DepartmentsCentres/HEC/SS-Application.rtf>

Po ashtu, duhet të dërgoni edhe një letër motivuese duke sqaruar shkaqet pse dëshironi të ndjekeni këtë shkollë verore. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen në formë elektronike në: hec.summerschool@eui.eu

Akomodimi dhe ushqimi janë të mbuluara nga organizatorët. Pjesëmarrësit duhet të mbulojnë me vetëfinancim shpenzimet e udhëtimit dhe sigurimin shëndetësor.

AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM: 15 MAJ 2010.

Për më shumë informacione vizitoni: www.eui.eu ose drejtohuni në **Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë - QESHK**.